RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

KOMUNIKATË

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës ka emëruar Drejtoreshën e re të edicionit të IV të Festivalit të Këngës në RTK.

Sot, me datë 25 korrik 2026, përmes votimit elektronik, Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, me votë unanime, emëroi znj. Arta Avdiu në pozitën e Drejtoreshës së edicionit të IV të Festivalit të Këngës në RTK.

Ky vendim vjen pas dorëheqjes së parevokueshme të z. Rilind Gërvalla nga pozita e Drejtorit të Festivalit të Këngës në RTK për edicionin e IV, pas së cilës Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së i paraqiti Bordit propozimin për emërimin e znj. Arta Avdiu në këtë pozitë.

Bordi i RTK-së, duke marrë parasysh propozimin dhe vlerësimin e Drejtoreshës së Përgjithshme lidhur me përvojën profesionale, angazhimin dhe kontributin e znj. Arta Avdiu në organizimin e edicioneve të mëparshme të Festivalit të Këngës në RTK, emëroi atë në këtë pozitë.

Bordi i RTK-së mbetet i përkushtuar për organizimin dhe realizimin me sukses të edicionit të IV të Festivalit të Këngës në RTK, si një aktivitet i rëndësishëm i kultivimit të artit muzikor dhe si pjesë e veprimtarisë programore e kulturore të transmetuesit publik.